



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT DHE PAGESAVE TË DËMEVE FOND
KOMPENSIMI ME DATË AKSIDENTI PËRPARA HYRJES NË FUQI
TË LIGJIT NR. 32/2021

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 103, datë 30.06.2021

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat e administrimit dhe pagesave të praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit, me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 59, pika 3, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit (më poshtë “Byroja”) krijuar sipas nenit 35 të Ligjit nr. 32/2021, anëtarë të së cilës janë shoqëritë e sigurimit, të licencuar për të

ushtruar veprimtari sigurimi sipas shkronjave “a” e “b” të nenit 2, të pikës 1, të Ligjit nr. 32/2021.

Neni 4

Kërkesat për dëmshpërblim

1. Të gjitha kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” trajtohen, paguhen dhe rimbursohen nga Byroja sipas legjislacionit në fuqi në datën e aksidentit.
2. Kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti pas 1 korrik 2021 trajtohen, paguhen dhe rimbursohen sipas dispozitave të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
3. Për ngjarjet e ndodhura përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021, nëse pala e dëmtuar i drejtohet shoqërisë së sigurimit, kjo e fundit e drejton tek Byroja, e cila regjistron kërkesën për dëmshpërblim dhe fillon procedurat e trajtimit dhe pagesës sipas legjislacionit dhe akteve rregullatore në fuqi në datën e aksidentit.
4. Kërkesat për dëmshpërblim të dëmeve Fond Kompensimi, sipas këtij neni, protokollohen dhe regjistrohen në regjistrin elektronik të dëmeve Fond Kompensimi, administruar nga Byroja.
5. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike. Kjo kërkesë është formular standard, i publikuar dhe në faqen zyrtare të internetit të Byrosë.

Neni 5

Mënyra, procedurat e trajtimit dhe pagesa e dëmeve

1. Byroja është e detyruar të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim, për dëmet e parashikuara në këtë rregullore dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim palën e dëmtuar.
2. Kufiri minimal i përgjegjësisë për dëmet e parashikuara në këtë rregullore është sipas legjislacionit në fuqi në datën e aksidentit.
3. Rregullat dhe metodologjia e llogaritjes së dëmshpërblimit sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje, janë në përputhje me rregulloren “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, në fuqi në datën e aksidentit.

4. Fondi i parashikuar me qëllim pagesën e dëmeve sipas kësaj rregulloreje, është pjesë e fondit të kompensimit të miratuar nga Autoriteti.

Neni 6

Dispozitat e fundit

1. Byroja administron të gjithë të dhënat e dëmeve të regjistruar në regjistrin elektronik të dëmeve fond kompensimi, sipas kësaj rregulloreje.
2. Byroja më datë 30 qershor 2021, gjeneron të dhënat analitike të të gjithë kërkesave për dëmshpërblim, të regjistruara në regjistrin elektronik të dëmeve Fond Kompensimi.
3. Raporti me evidentimin e të dhënave sipas pikës 2 më sipër, depozitohet në Autoritet më datë 1 korrik 2021.
4. Të dhënat statistikore mujore dhe progresive në lidhje me pagesat dhe detyrimet e dëmeve parashikuar në këtë rregullore, do të bëhen në përputhje me rregulloren “Për standartet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021.